

# Studentët e shkëlqyer dhe me rezultate

## Viti akademik 2024 - 2025

### Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-s nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, VKM-s nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit,” i ndryshuar, VKM-s Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, VBA-së nr. 50 datë 28.10.2024 “Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve “Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit” dhe ngritjen e Komisionit “Ad Hoc”, VBA-së nr. 51 datë 28.10.2024 “Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve “Për ulje tarife vjetore shkollimi në vitin akademik 2024-2025, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi të Ciklit të dytë të studimeve - Master”.

#### NJOFTON:

##### A- Studentët e shkëlqyer

- Përjashtimisht studentët e shkëlqyer me notë mesatare 10-të në një program të parë studimi**, që ndjekin një program të dytë studimi të përfitojnë **përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që vazhdojnë studimet në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit**. Ky kriter vlen edhe për studentët e vitit të dytë e të tretë që mesataren e vitit paraardhës e kanë 10-të por që janë studentë të shkëlqyer me notë mesatare 10-të në një program të parë studimi.
- Përjashtimisht studentët e shkëlqyer me notë mesatare 10-të në një program të parë studimi**, që ndjekin një program të dytë studimi të përfitojnë **ulje tarife vjetore shkollimi për Ciklin e dytë të studimeve**. Ky kriter vlen edhe për studentët e vitit të dytë, që mesataren e vitit paraardhës e kanë 10-të por që janë studentë të shkëlqyer me notë mesatare 10-të në një program të parë studimi.

##### B- Studentët në programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit, në program të parë studimi, sipas VKM-s “studentët me rezultate”, të cilët në vitin akademik 2024-2025 janë:

- Në vitin e dytë dhe të tretë dhe rezultojnë me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9.<sup>00</sup> (nëntë) deri 10.<sup>00</sup> (dhjetë), përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit. Mesatarja e ponderuar për llogaritjet:
  - Për studentët e vitit të dytë mesatare e ponderuar llogaritet për notat e marra në vitin e parë (shumëzohet nota e secilës lëndë me kreditet e saj, shuma që del pjestohet me 60 kreditet e vitit të parë)
  - Për studentët e vitit të tretë mesatare e ponderuar llogaritet për notat e marra në vitin e dytë (shumëzohet nota e secilës lëndë me kreditet e saj, shuma që del pjestohet me 60 kreditet e vitit të dytë)

Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.

Listat e studentëve që rezultojnë me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9.00 (nëntë) deri 10.00 (dhjetë), do të përgatiten nga sekretaritet mësimore të fakultetit dhe do të paraqiten në Rektorat për përpunimin e të dhënave dhe vendimarrje në Bordin e Administrimit.

Studentët që plotësojnë kriterin e mësipërm do të paraqesin në Drejtorinë ekonomike numrin e llogarisë bankare pranë Raiffeisen bank (ose të konfirmojnë numrin e llogarisë nëse kanë përfituar një vit më parë)

- Të regjistruar në vitin e parë dhe rezultojnë me notë mesatare vjetore nga 9.<sup>00</sup> (nëntë) deri 10.<sup>00</sup> (dhjetë), përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit. Mesatarja vjetore për llogaritjet, si mesatare aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë, duke përfshirë edhe notat e provimeve të Maturës Shtetërore

Listat e studentëve që rezultojnë me notë mesatare vjetore nga 9.00 (nëntë) deri 10.00 (dhjetë), paraqiten në Rektorat për vendimarrje në Bordin e Administrimit, nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH)

Studentët që plotësojnë kriterin e mësipërm do të paraqesin në Drejtorinë ekonomike numrin e llogarisë bankare pranë Raiffeisen bank.

##### C- Studentët e Ciklit të dytë – Master i Shkencave e Master profesional, me program të parë studimi, sipas VKM-s “studentët e shkëlqyer”, të cilët në vitin akademik 2024-2025 janë në vitin e parë dhe të dytë (brenda kohës normale të programit të studimit) dhe rezultojnë me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9.00 (nëntë) deri 10.00 (dhjetë), përfitojnë ulje të tarifës vjetore të shkollimit. Mesatarja e ponderuar për llogaritjet:

- Për studentët e vitit të parë, mesatare e ponderuar llogaritet për notat e marra në të gjitha vitet e Ciklit të parë të studimeve (shumëzohet nota e secilës lëndë me kreditet e saj, shuma që del pjestohet me kreditet e të gjithë viteve).
- Për studentët e vitit të dytë, mesatare e ponderuar llogaritet për notat e marra në vitin e parë të Ciklit të dytë të studimeve (shumëzohet nota e secilës lëndë me kreditet e saj, shuma që del pjestohet me 60 kreditet e vitit të parë)

Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.

Listat e studentëve që rezultojnë me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9.00 (nëntë) deri 10.00 (dhjetë), do të përgatiten nga sekretaritet mësimore të fakultetit dhe do të paraqiten në Rektorat për përpunimin e të dhënave dhe vendimarrje në Bordin e Administrimit.

#### REKTORATI